



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.168/6 prot.

Datë 22.02.2024

V E N D I M

Nr. 213/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22.02.2024 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga BOE “Erdis” SHPK dhe “Nelsa” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-89079-11-24-2023, me objekt “Blerje fruta dhe zarzavate” me fond limit 77,694,098.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 03.01.2024, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve Tiranë.
- Ankimues:** BOE “Erdis” SHPK dhe “Nelsa” SHPK me NIPT K71804011J dhe adresë: Njësia Administrative Nr.12, Rruga Nacionale e Dajtit, Zona Kadastrale Nr. 2460, Numër Pasurie 199/32-G1, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve Tiranë me adresë: Rr. “Barrikadave”, Tiranë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të

Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 30.11.2023, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-89079-11-24-2023, me objekt “Blerje fruta dhe zarzavate”, me fond limit 77,694,098.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 03.01.2024, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve Tiranë.

II.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 11.01.2024, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- BOE "Erdis" SHPK dhe "Nelsa" SHPK	72,727,450.00 lekë	skualifikuar
- "Agro-Koni" SHPK	72,947,297.00 lekë	kualifikuar
- "Dajti Park" SHPK	74,551,225.00 lekë	skualifikuar

BOE ankimues "Erdis" SHPK dhe "Nelsa" SHPK, rezulton i skualifikuar me arsyetimin:

"Kriteret e veçanta, kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 2.2.2, operatori ekonomik ERDIS ShPK anëtar i bashkimit operator, në dokumentin e paraqitur në përmbushje të këtij kriteri, rezulton se xhirot vjetore të 2021 dhe 2022 të jenë disa herë më të vogla se përqindja e pjesëmarrjes së aktmarrëveshjes të BOE. Referuar VKM Nr. 285 , datë 19.05.2021 i ndryshuar, neni 88, pika 3 "...Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje...", për rrjedhojë BOE nuk e përmbush këtë kriter."

II.3. Në datën 16.01.2024, nga verifikimi në sistemin elektronik rezulton, se është publikuar njoftimi i fituesit paraprak.

II.4. Në datën 24.01.2024, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është paraqitur ankesa me numër 168 prot., e BOE "Erdis" SHPK dhe "Nelsa" SHPK, ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit objekt - ankimi konkretisht në mënyrë të përmbledhur, duke pretenduar se: "[...]

1. MBI ANKESËN

Në lidhje me arsyen e skualifikimit me arsyetimin se: "2.1 Kriteret e veçanta, kapaciteti ekonomik dhe financiar pika 2.2.2, operatori "Erdis" ShPK anëtar i bashkimit të operatorëve, në dokumentin e paraqitur në përmbushje të këtij kriteri,, rezulton se xhirot vjetore të 2021 dhe 2022 të jenë disa herë më të vogla se përqindja e pjesëmarrjes së aktmarrëveshjes të BOE. Referuar VKM Nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, neni 88, pika 3 "...Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje..." , për rrjedhojë BOE nuk e përmbush këtë kriter.", vlerësojmë se është tërësisht e padrejtë dhe e pabazuar në ligj dhe si e tillë nuk qëndron.

Në shtojcën 7 "Kriteret e Veçanta të Kualifikimit", "Kapaciteti ekonomik dhe financiar" të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi është parashikuar se operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë: "2.2.2 Vërtetim nga organet tatimore, për xhiron vjetore për 2 vitet e fundit financiare, 2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e lotit (fondi limit i lotit).

Kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, alo i shërbejnë Autoriteti Kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të Operatorëve Ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. "

Së pari, kërkojmë të sqarojmë se në procedurën e prokurimit objekt ankimi kemi dorëzuar ofertën në formën ec bashkimit të operatorëve ekonomikë, sipas kontratës së bashkëpunimit me Nr.repertori 2485, Nr.koleksioni 1077, datë 29.12.2023.

Bazuar në këtë kontrate lidhur mes palëve ndër të tjera parashikohet se 55% e kapacitetit teknik, financiar do të vihen në dispozicion nga shoqëria “Nelsa” ShPK ndërsa 45% kapacitetit teknik, financiar do të vihen në dispozicion nga shoqëria “Erdis” ShPK, me përjashtimit të kërkesës të xhiros vjetore e cila do të përmbushet në masën 80% nga shoqëria “Nelsa” ShPK dhe 20% nga shoqëria “Erdis” ShPK.

Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 16272020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale,
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë,
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”

Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se:

- “1. Auloritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Auloritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. ,
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën. ”

Në nenin 14 “Operatorët ekonomikë”, të ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se:

- “1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.
2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t'i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.

Autoritetet ose entet kontraktore mund t'u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t'u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.

3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik. ”

Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në.

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale,

b) gjendjen ekonomike dhe financiare:

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar.

Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalohet dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: I. Autoriteti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar,

b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar,

c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

5. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen

në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

6. Në çdo rast, kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. ”

Në nenin 88 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve. 2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

4. Operatori ekonomik, anëtar i një bashkimi, nuk mund të paraqesë njëkohësisht edhe oferta individuale. Bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk ndryshon pas dorëzimit të ofertës, në të kundërt oferta e tij refuzohet. Autoriteti ose enti kontraktor, para lidhjes së kontratës, mund të kërkojë që bashkimi i operatorëve ekonomikë të krijohet zyrtarisht me një marrëveshje të noterizuar.

5. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.

6. Në rast falimentimi të një prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë ose në rrethana të tjera, që ndërpresin veprimtarinë e tij gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti enti kontraktor mund të vazhdojë kontratën me operatorët e tjerë ekonomikë, anëtarë të bashkimit, me kusht që ai të zotërojë kapacitetet ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike për të zbatuar kontratën. Përndryshe, autoriteti enti kontraktor zgjidh kontratën. ”’

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti

kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u - ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik". Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

Në një interpretim të kuadrit ligjor të mësipërm konstatojmë se në marrëveshjen e bashkëpunimit operatorët ekonomikë përcaktojnë zërat dhe elementët konkretë të bashkëpunimit në përputhje ligjin "Për Prokurimin Publik" dhe aktet nënligjore në zbatim të tij duke përcaktuar konkretisht jo vetëm mjetet, stafin si dhe volumin dhe natyrën e angazhimit të secilit prej anëtarëve të bashkimit në realizimin me sukses të kontratës por gjithashtu kanë përcaktuar saktësisht edhe përmbushjen e secilit prej kapaciteteve ekonomiko-financiar, teknik, profesional nga secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë.

Më konkretisht, në përmbushje të kriterit të mësipërm bashkimi i operatorëve ekonomikë "Erdis" ShPK dhe "Nelsa" ShPK kanë dorëzuar:

- Operatori ekonomik "Erdis" ShPK Vërtetim "Për Xhiron e Tre Viteve Të Fundit" Nr.T09636816, datë 25.12.2023;

- Operatori ekonomik "Nelsa" ShPK Vërtetim "Për Xhiron e Tre Viteve Të Fundit" Nr. T09636819, datë 25.12.2023 , Kontratë bashkëpunimi me Nr. Repertori 2485, Nr. Koleksioni 1077, datë 29.12.2023.

Fillimisht kërkojmë të theksojmë se në kontratën e bashkëpunimit me Nr. Repertori 2485, Nr. Koleksioni 1077, datë 29.12.2023 parashikohet specifikisht se 55 % e kapacitetit teknik, financiar do të vihen në dispozicion nga shoqëria "Nelsa" ShPK ndërsa 45 % e kapacitetit teknik, financiar do të vihen në dispozicion nga shoqëria "Erdis" ShPK, me përjashtim të kërkesës të xhiros vjetore e cila do të përmbushet në masën 80% nga shoqëria "Nelsa" ShPK dhe 20% nga shoqëria "Erdis" ShPK, pra theksojmë se është parashikuar shprehimisht në kontratën e bashkëpunimit përqindja që përmbush secili nga anëtarë e bashkimit për secilin prej kapaciteteve në përgjithësi si dhe përqindja që do të përmbushet nga secili nga anëtarët e bashkimit për këtë kriter në veçanti.

Në rastin konkret vlerësojmë se autoriteti kontraktor nuk mund të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore dokumentacionin e dorëzuar nga operatorët ekonomikë, por duhet të shqyrtojë në themel këtë dokumentacion pasi kapacitetet ekonomiko-financiare, teknike si dhe profesionale të cilat parashikohen nga ligji "Për Prokurimin Publik" dhe aktet nënligjore në zbatim të tij përmbushen në përputhje me ndarjen dhe përqindjen e parashikuar në kontratën e bashkëpunimit pra:

- Jo më pak se 45% kontrata të ngjashme për operatorin ekonomik "Erdis" ShPK , jo më pak se 55 % kontrata të ngjashme për operatorin ekonomik "Nelsa" ShPK :

- Jo më pak se 45 % numrit total të punonjësve nga operatori ekonomik “Erdis” ShPK, Jo më pak se 55 % e numrit total të punonjësve nga operatori ekonomik “Nelsa” ShPK .
- Jo më pak se 45% e certifikimeve ISO për operatorin ekonomik “Erdis” ShPK, Jo më pak 55 % e certifikimeve ISO për operatorin ekonomik “Nelsa” ShPK.
- Jo më pak se 20% e xhiros vjetore për operatorin ekonomik “Erdis” ShPK Jo më pak 80 % xhiros vjetore për operatorin ekonomik “Nelsa” ShPK; etj.

Sa më sipër, gjykojmë se autoriteti kontraktor nuk mund të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimes, por duhet të shqyrtojë në themel këtë dokumentacion duke marrë në konsideratë përmbushjen e kapaciteteve ekonomiko-financiare, teknike si dhe profesionale në bazë të përqindjes të parashikuar në kontratën e bashkëpunimit të lidhur midis palëve.

Në një interpretim literal dhe sistematik të kuadrit ligjor në fuqi vlerësojmë se qëllimi i ligjit “Për Prokurimin Publik” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij është maksimizimi i efikasitetit së procedurës së prokurimit në zbatim të parimeve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, ndërsa qëllimi i hartimit dhe vendosjes së kriterëve për kualifikim është që autoriteti kontraktor të krijojë një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushjen me sukses të kontratës, pra të krijojnë bindjen që operatorët ekonomikë pjesëmarrës kanë kapacitetet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.

Në rastin konkret, meqenëse kemi të bëjmë me një procedurë prokurimi në të cilën kemi dorëzuar ofertën në formën e bashkimit të operatorëve ekonomikë, sipas kontratës së bashkëpunimit me Nr. Repertori 2485, Nr. Koleksioni 1077, datë 29.12.2023, vlerësojmë se për autoritetin kontraktor e rëndësishme është që bashkimi i operatorëve së bashku, të cilët paraqiten në procedurën e prokurimit si një i vetëm, së bashku të përmbushin kriteret e parashikuara në DST dhe rrjedhimisht të krijojnë bindjen për autoritetin kontraktor për realizimin me sukses të kontratës.

Në rastin konkret, gjykojmë se për aq kohë sa në kontratën e bashkëpunimit me Nr. Repertori 2485, Nr. Koleksioni 1077, datë 29.12.2023 është parashikuar shprehimisht se për sa i përket kërkesës për disponimin e xhiros vjetore 20% e xhiros vjetore do të përmbushet nga operatori ekonomik “Erdis” ShPK dhe 80 % xhiros vjetore do të përmbushet nga operatori ekonomik “Nelsa” ShPK dhe për aq kohë sa bazuar në këtë ndarje të bërë në kontratën e bashkëpunimit, ky kriter përmbushet nga bashkimi i operatorëve ekonomikë, rrjedhimisht gjykojmë, se oferta e dorëzuar nga BOE “Erdis” ShPK dhe “Nelsa” ShPK është oferta me çmim më të ulët që përmbush të gjitha kërkesat e parashikuara në dokumentet standarde të tenderit dhe si e tillë duhet të kualifikohet.

Gjithashtu gjykojmë se për aq kohë sa legjislacioni në fuqi nuk e ndalon bashkimin e operatorëve të bëjnë një ndarje të tillë të kapaciteteve që disponojnë por në një interpretim të legjislacionit në fuqi bashkimi i operatorëve ekonomikë vepron si një i vetëm në mënyrë të tillë që të krijojnë bindjen për autoritetin kontraktor për realizimin me sukses të kontratës, dhe për aq kohë sa në rastin konkret për sa i përket kërkesës për kualifikim përmbushet nga bashkimi i operatorëve ekonomikë sipas ndarjes në përqindje të parashikuar në kontratën e bashkëpunimit me Nr. Repertori 2485, Nr. Koleksioni 1077, datë 29.12.2023, gjykojmë se oferta e dorëzuar nga BOE “Erdis” ShPK dhe “Nelsa” ShPK është kualifikuar në mënyrë të padrejtë dhe të pabazuar në ligj dhe në fakt pasi është oferta me çmimin më të ulët të që

përmbush të gjitha kërkesa e parashikuara në dokumentet standarde të tenderit dhe si e tillë duhet të kualifikohet.

Në gjykimin tonë me dokumentacionin e dorëzuar në SE nga bashkimi i operatorëve ekonomikë si dhe në interpretim të drejtë të kuadrit ligjor në fuqi autoriteti kontraktor arrin që të krijojë bindjen dhe sigurinë për realizimin me sukses të kontratës pasi kjo kontratë po përmbushte me sukses nga ky bashkim operatorësh për procedurën zhvilluar në vitin 2023 nga autoriteti kontraktor “Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve Tiranë.”

Sa më sipër vlerësojmë se arsyeja e mësipërme e skualifikimit është tërësisht e pabazuar në ligj dhe në fakte dhe për këtë arsye nuk qëndron.

Gjithashtu theksojmë se skualifikimi në mënyrë të padrejtë dhe të pabazuar në ligj dhe në fakte i ofertës sonë i shkakton një dëm ekonomik buxhetit të “Bashkisë Tiranë” pasi është oferta me çmimin më të ulët që përmbush të gjitha kërkesat e parashikuara në dokumentet standarde të tenderit.

Sa më sipër kërkojmë:

- 1. Pezullimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi*
- 2. Kualifikimin e ofertës së BOE “Erdis” ShPK dhe “Nelsa” ShPK”*

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr.168/2 prot., datë 25.01.2024, u publikuan arsyet e skualifikimit të BOE ankimues.

II.6. Me shkresën nr. 120/7 prot., datë 01.02.2024, protokolluar me tonën me nr.168/3 prot., datë 05.02.2024, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni lidhur me trajtimin e ankesës të BOE ankimues “Erdis” SHPK dhe “Nelsa” SHPK, bashkëlidhur së cilës gjendet dokumenti me emërtimin “Ekstrakti i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave” i datës 01.02.2024, në të cilin konstatohet se autoriteti kontraktor nuk e ka pranuar ankesën, duke arsyetuar si më poshtë:

“Për sa më sipër, sqarojmë se, Komisioni i vlerësimit të ofertave, pasi është njohur me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit, si dhe dokumentet provuese të QE që kanë marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi vendosi të mos kualifikojë BOE Erdis ShPK dhe Nelsa ShPK, pasi nuk përmbush kriterin 2.2.2.

Në lidhje me pretendimin e OE se: “Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomik pjesëmarrës në procedurat e prokurimit”, sqarojmë se Autoriteti ynë Kontraktor në Zbatim të LPP dhe akteve të tjera nënligjore që rregullojnë zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, harton kriteret e kualifikimit jo vetëm për të krijuar panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorëve ekonomikë, por me qëllim që të sigurohet plotësisht që OE, që më pas do të mundësojë furnizimin me ushqime për çerdhet dhe kopshtet publike për 12 muaj kalendarikë në mënyrë të përditshme, disponon të gjitha mundësitë për

furnizimin e vazhdueshëm dhe të pandërprerë me artikuj ushqimor cilësor për të gjitha çerdhet dhe kopshte publike.

Për sa i përket pretendimit se: “Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë. se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Në një interpretim të kuadrit ligjor të mësipërm konstatojmë se në marrëveshjen e bashkëpunimit operatorët ekonomikë përcaktojnë zërat dhe elementët konkretë të bashkëpunimit në përputhje ligjin “Për Prokurimin Publik” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij duke përcaktuar konkretisht Jo vetëm mjetet, stafin si dhe volumin dhe natyrën e angazhimit të secilit prej anëtarëve të bashkimit në realizimin me sukses të kontratës por gjithashtu kanë përcaktuar saktësisht edhe përmbushjen e secilit prej kapaciteteve ekonomiko-financiar, teknik, profesional nga secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë”, sjellim në vëmendje të OE ankimese se në ankesën e tij nuk gjejmë të argumentuar se në cilin rast AK nuk ka zbatuar parimin e barazisë dhe transparencës. Komisioni i vlerësimit të ofertave gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga OE, konkretisht për kriterin 2.2.2, i është referuar parashikimeve të VKM nr.285 datë 19.05.2021, 1 ndryshuar, neni 88 pika 3 ku citohet: Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Për sa më sipër nuk është në tagrin e OE të përcaktoj mënyrën e vlerësimit për secilin kriter, pasi mënyra e vlerësimit të kapaciteteve teknike e ato ekonomike është përcaktuar në VKM e sipërpërmendur duke ju referuar ndarjes së punëve që është përcaktuar nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomik në marrëveshjen e bashkëpunimit.

Për sa i përket pretendimit se: “Në rastin konkret vlerësojmë se autoriteti kontraktor nuk mund të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore dokumentacionin e dorëzuar nga operatorët ekonomikë, por duhet të shqyrtojë në themel këtë dokumentacion pasi kapacitetet ekonomiko-financiarë, teknike si dhe profesionalë të cilat parashikohen nga ligji “Për Prokurimin Publik” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij përmbushen në përputhje me ndarjen dhe përqindjen e parashikuar në kontratën e bashkëpunimit pra: Jo më pak se 45% kontrata të ngjashme për operatorin ekonomik “Erdis” ShPK, Jo më pak se 55 % te kontrata të ngjashme për operatorin ekonomik “Nelsa” ShPK, Jo më pak së 45 % e numrit total të punonjësve nga operatori ekonomik “Erdis” ShPK. Jo më pak së 55 % e numrit total të punonjësve nga operatori ekonomik “Nelsa” ShPK: jo me pak së 45% e certifikimeve ISO për operatorin ekonomik “Erdis” ShPK.

Jo më pak 55 % e certifikimeve ISO për operatorin ekonomik “Nelsa” ShPK: Jo më pak së 20% e xhiros vjetore për operatorin ekonomik “Erdis” ShPK,

Jo më pak 80 % xhiros vjetore për operatorin ekonomik” Nelsa” ShPK etj.”, sqarojmë se referuar LPP neni 14 pika 3 ku citohet: Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik., është përcaktuar se mënyra e vlerësimit për plotësimin e kriterëve nga Bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk përcaktohet në marrëveshjen e bashkëpunimit por në Rregullat e Prokurimit Publik. Rrjedhimisht në VKM nr. 285 datë 19.05.2021 i ndryshuar përcaktohet: ” Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e

pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”, pra plotësimi i kapaciteteve ekonomike apo teknike duhet të jetë në përputhje me përqindjen e furnizimit.

Për sa i përket pretendimit se: gjykojmë se oferta e dorëzuar nga BOE “Erdis” ShPK dhe “Nelsa” ShPK është skualifikuar në mënyrë të padrejtë dhe të pabazuar në ligj dhe në fakt pasi është oferta më çmimin më të ulët që përmbush të gjitha kërkesat e parashikuara në dokumentet standarde të tenderit dhe si e tillë duhet kualifikohet. Në gjykimin tonë, me dokumentacionin e dorëzuar në SPE nga bashkimi i operatorëve ekonomike si dhe në interpretim të drejtë të kuadrit ligjor në fuqi autoriteti kontraktor ky kriter përmbushet nga BOE si dhe gjithashtu autoriteti kontraktor arrin që të krijojë bindjen dhe sigurinë për realizimin me sukses të kontratës, pasi kjo kontratë po përmbushet me sukses nga ky bashkim operatorësh për procedurën e zhvilluar në vitin 2023 nga autoriteti kontraktor “Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve Tiranë”., sqarojmë se sikurse citohet edhe në ankesën e OE, klasifikimi sipas çmimit më të ulët kryhet vetëm për operatorët ekonomik pjesëmarrës që përmbushin të gjitha kriteret dhe kapacitet teknike dhe ekonomike të përcaktuara në DST. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik “Erdis” ShPK dhe “Nelsa” ShPK nuk plotësojnë kriterin 2.2.2 në përputhje me përqindjen e furnizimit të përcaktuar në marrëveshjen e bashkëpunimit.

Për sa i përket pretendimit se: “Gjithashtu theksojmë se skualifikimi në mënyrë të padrejtë dhe të pabazuar në ligj dhe në fakte i ofertës sonë i shkakton një dëm ekonomik buxhetit të “Bashkisë Tiranë” pasi është oferta me Çmimin më të ulët që përmbush të gjitha kërkesat e parashikuara në dokumentet standarde të tenderit.

Sa më sipër kërkojmë:

- 1. Pezullimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi*
- 2. Kualifikimin e ofertës së BOE “Erdis” ShPK dhe “Nelsa” ShPK, sqarojmë se sikurse u përmend më lart, vetëm në rast se oferta e paraqitur nga operatorët ekonomik pjesëmarrës plotëson kriteret e kualifikimit kryhet renditja sipas çmimit më të ulët. Oferta e paraqitur nga BOE nuk plotëson kriteret. Ne lidhje me kërkesën tuaj për pezullimin e procedurës, referuar parashikimeve ligjore dhe akteve nënligjore që rregullojnë procedurat e prokurimit publik, kjo procedurë është pezulluar, sipas Urdhrit të Titullarit të AK nr. 78 datë 24.01.2024, deri në shpalljen e vendimit nga KPP. Në lidhje me kërkesën e BOE për kualifikimin në këtë procedure prokurimi, theksojmë se sipas arsytimit të mësipërm ky pretendim nuk qëndron. Në përfundim theksojmë se Autoriteti ynë Kontraktor, sipas parashikimeve të Ligjit nr.162.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, gjatë shqyrtimit të ofertave ka shqyrtuar dhe verifikuar të gjitha dokumentet provuese që operatorët ekonomik ofertues në këtë procedure prokurimi kanë depozituar në SPE, dhe referuar kriterëve të përgjithshme e të veçanta të përcaktuara në Dokumentet Standarde të Tenderit ka kryer klasifikimin e operatorëve ekonomik pjesëmarrës. Për sa më sipër, pretendimi i BOE ankimues nuk qëndron.*

VENDOSI

Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik “Erdis” ShPK dhe “Nelsa” ShPK, në lidhje me vlerësimin për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me objekt “Blerje Ushqime për vitin 2024”, konkretisht loti V “Blerje fruta dhe zarzavate”, me fond limit lek pa TVSh.”

II.7. Gjithashtu, nga informacioni i autoritetit kontraktor rezulton, se ankesa e BOE ankimues “Erdis” SHPK dhe “Nelsa” SHPK, është paraqitur pranë këtij të fundit më datë 24.01.2024 me nr. 120 prot.

II.8. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk ka argumente të paraqitura nga subjekte të interesuara, në kuptim të nenit 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e BOE ankimues “Erdis” SHPK dhe “Nelsa” SHPK, për skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit me arsyen se: “

“Kriteret e veçanta, kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 2.2.2, operatori ekonomik ERDIS ShPK anëtar i bashkimit operator, në dokumentin e paraqitur në përmbushje të këtij kriteri, rezulton, se xhirot vjetore të 2021 dhe 2022, të jenë disa herë më të vogla se përqindja e pjesëmarrjes së aktmarrëveshjes të BOE. Referuar VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, neni 88, pika 3 “...Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje...”, për rrjedhojë BOE nuk e përmbush këtë kriter.” KPP vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 7, Loti V-“Blerje fruta dhe zarzavate”, kriteret e veçanta të kualifikimit, Kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 2.2.2, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

2.2.2 Vërtetim nga organet tatimore, për xhiron vjetore për 2 vitet e fundit financiare, 2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përllogaritur e lotit(fondi limit i lotit).

Kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, ato i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të Operatorëve Ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

III.1.2. Në përmbushje të kërkesës më sipër, BOE ankimues ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin si më poshtë:

-Vërtetim Nr.T09636816 datë 25.12.2023 për xhiron e tre viteve të fundit (2020,2021,2022) lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë për tatimpaguesin “Erdis” SHPK ku xhiro vjetore për periudhën tatimore të vitit 2021 është x lekë; dhe vitin 2022 është x lekë.

- Vërtetim Nr.T09636819 datë 25.12.2023 për xhiron e tre viteve të fundit (2020,2021,2022) lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë për tatimpaguesin “Nelsa” SHPK, ku xhiro vjetore për periudhën tatimore te vitit 2021 është x lekë; dhe vitin 2022 është x lekë.

III.1.3. Në nenin 14 pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”

Në nenin 77, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohej operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.4. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 3, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përputhje me të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Ndërsa në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 1, 2 dhe 3 e Vendimit Nr. 285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: *“1.Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.*

2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:*

- a) *dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit¹, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;*
- b) *vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;*
- c) *40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.*

3. *Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.”*

Në nenin 88, pika 3 të Vendimit Nr. 285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: *“3.Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.*

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”

Në nenin 90, pika 1 dhe 2 të Vendimit Nr. 285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: 1. *Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së.*

2. *Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet:*

¹ Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

- *ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;*
- *t'i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme.*
- *t'i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së.*
- *Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.*

III.1.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese dhe specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.6. Nisur nga pretendimet e BOE ankimues, lidhur me përmbushjen nga ana e tij të kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në shtojcën 7 të dokumenteve të tenderit për lotin V “Blerje fruta dhe zrazavate”, kriteret e veçanta të kualifikimit, kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 2.2.2, KPP konstaton, se me dokumentacionin e paraqitur, BOE ankimues dhe më konkretisht operatori ekonomik “Erdis” SHPK, si pjesë e bashkimit, nuk i përmbush kërkesat e autoritetit kontraktor. Në nenin 14, pika 3, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.” Ndërsa në nenin 88, pika 3 të Vendimit Nr. 285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE rezulton, se në marrëveshjen e bashkëpunimit të datës 29.12.2023 me nr. Repertori 2485 dhe nr. Koleksioni 1077, të nënshkruar mes shoqërisë “Nelsa” SHPK dhe shoqërisë “Erdis” SHPK, përkatësisht në nenin 4 “Pjesëmarrja” rezulton, se pjesëmarrja e shoqërive e shprehur në përqindje është: “Shoqëria “Nelsa” SHPK do të kontribuojë në total në masën 55% në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë pjesën e furnizimit me produktet e fruta dhe zrazavate si dhe në dispozicion punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet e nevojshme për transportimin e produkteve të procedurës objekt prokurimi;

Shoqëria “Erdis” SHPK do të kontribuojë në total në masën 45% në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë furnizimin me produktet e fruta dhe zrazavate si dhe vënien në dispozicion të një mjeti si dhe punonjësve të nevojshëm për transportin e produkteve të procedurës objekt ankimi. Transporti i produkteve do të realizohet me mjetet e vëna në dispozicion nga të dy anëtarët e bashkimit të operatorëve si dhe me kontributin e stafit nga të dy anëtarët e bashkimit të operatorëve. Shoqëritë e mësipërme sipas përqindjes së pjesëmarrjes në këtë pjesëmarrje do të kontribuojnë edhe me kapacitetin teknik, financiar të cilat do të vendosen në dispozicion për të përmbushur plotësisht objektin e kontratës. Bazuar në këtë kontratën e lidhur mes palëve 55% e kapacitetit teknik, financiar do të vihen në dispozicion nga shoqëria “Nelsa” SHPK ndërsa 45% e kapacitetit teknik, financiar do të vihen në dispozicion nga shoqëria “Erdis” SHPK me përjashtim të xhiros vjetore e cila do të përmbushet në masën 80% nga shoqëria “Nelsa” SHPK dhe 20% nga shoqëria “Erdis” SHPK. Në interpretim të bazës ligjore të sipërcituar, si duke e parë të lidhur ngushtë dhe më përmbajtjen e marrëveshjes së bashkëpunimit të datës 29.12.2023 me nr. Repertori 2485 dhe nr. Koleksioni 1077, të nënshkruar mes shoqërisë “Nelsa” SHPK dhe shoqërisë “Erdis” SHPK, Komisioni gjykon, se ndodhemi para rastit kur BOE duhet të plotësojë njërën prej pikave të kapacitetit ekonomik dhe financiar, konkretisht pikën 2.2.2 lidhur me xhiron vjetore dhe ku sipas nenit 88, pika 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ky kriter duhet të përmbushet nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Sipas aktmarrëveshjes më sipër shoqëria “Nelsa” SHPK, do të kontribuojë në total në masën 55% në këtë pjesëmarrje, ndërsa shoqëria “Erdis” SHPK, do të kontribuojë në total në masën 45%, çfarë do të thotë se

kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me këtë përqindje të përcaktuar në aktmarrëveshje. Ligjvënësi ka qenë i qartë kur ka përcaktuar në nenin 14 pika 3 të *lex specialis*, se rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen nga rregullat e prokurimit publik dhe sipas këtyre rregullave, kërkesat ekonomike, financiare, teknike, profesionale, plotësohen nga i gjithë bashkimi në përputhje me përqindjen e përcaktuar në aktmarrëveshje, e cila në rastin konkret është një kontribut në total në pjesëmarrje në masën 55% nga shoqëria “Nelsa” SHPK dhe 45% nga shoqëria “Erdis” SHPK, kontribut të cilit KPP, gjykon se duhet t’i referohemi për verifikimin e plotësimit të kriterit të përcaktuar në pikën 2.2.2 nga secili prej anëtarëve të bashkimit, pasi në interpretim të nenit 14 pika 3 të *lex specialis* mënyra e vlerësimit për

përmbushjen e kriterëve nga bashkimi i operatorëve ekonomikë përcaktohet nga rregullat e prokurimit publik, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes dhe jo nga marrëveshja e bashkëpunimit. Referuar sa më sipër, KPP vëren, se operatori ekonomik “Erdis” SHPK si pjesë e bashkimit dhe në përputhje me kontributin në total në pjesëmarrje prej 45% nuk e përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 2.2.2 të kapacitetit ekonomik e financiar, pasi vlera e xhiron vjetore për të paktën njërin nga vitet e periudhës së kërkuar (2021, 2022) nuk rezulton të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e fondit limit të lotit. Akoma më tej, KPP në funksion të një hetimi të thelluar administrativ dhe të shqyrtimit në mënyrë shterruese të gjitha rrethanave e fakteve që lidhen me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues dhe me arsyen e skualifikimit të tij, verifikoi edhe përmbajtjen e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit të secilit prej anëtarëve të bashkimit, me qëllim vërtetimin nëse operatorët ekonomikë kishin deklaruar mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera apo jo. Nga verifikimi rezultoi, se në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, operatori ekonomik “Nelsa” SHPK kishte deklaruar në seksionin B *“Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik”* emrin e operatorit ekonomik “Erdis” SHPK, si subjekt mbi kapacitetin e të cilit do të mbështetet, ndërsa operatori ekonomik “Erdis” SHPK në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit në po këtë seksion, ka deklaruar emrin e operatorit ekonomik “Nelsa” SHPK, si subjekt mbi kapacitetin e të cilit do të mbështetet. Referuar nenit 90 pika 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021, *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, parashikohet se: *“2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet: Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.”* Në këtë rast, referuar kontributit në total në pjesëmarrje prej 45% të operatorit ekonomik “Erdis” SHPK, i cili ka deklaruar operatorin ekonomik “Nelsa” SHPK si subjekt mbi kapacitetin e të cilit do të mbështetet, ai sërish nuk plotëson të paktën 50% (aplikuar për shifrën 45% sipas përqindjes së tij në pjesëmarrjes) të kërkesave të autoritetit kontraktor në lidhje me xhiron vjetore, të të paktën njërit prej dy viteve të fundit të kërkuara (2021, 2022). KPP sqaron, se mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor, e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme. BOE ankimues duhej të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Erdis” SHPK, si pjesë e bashkimit në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm, e rrjedhimisht, pretendimi i BOE ankimues nuk qëndron.

Sa më sipër, pretendimi i BOE ankimues “Erdis” SHPK dhe “Nelsa” SHPK nuk qëndron.

III.2. Gjithashtu, Komisioni sqaron, se nëse operatori ekonomik do të kishte pretendime në lidhje me kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, ka pasur në

dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës lidhur me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit, parashikuar nga neni 110 pika 1 e ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet se *“1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”* Akoma më tej, kuadri ligjor parashikon një sërë elementesh si garanci për operatorët ekonomikë, të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik do të kishte paqartësi në lidhje me plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në gjashtë ditë para dorëzimit të ofertave, parashikuar nga pika 1 e nenit 75 të LPP-së, ku përcaktohet se *“1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit.* Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit [...]”

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik” Neni 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga BOE ankimues BOE “Erdis” SHPK dhe “Nelsa” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-89079-11-24-2023, me objekt “Blerje fruta dhe zarzavate” me fond limit 77,694,098.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 03.01.2024, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga BOE ankimues “Erdis” SHPK dhe “Nelsa” SHPK.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

